

AKTIVITET 9

TAKIM ME PROFESIONISTË TË FUSHAVE

Për të orientuar më shumë nxënësit drejt së ardhmes së tyre, për të zgjeruar më tej konceptin e njohjes së vetvetes dhe vetëdijes në aftësitë e tyre, ne organizuam një takim me ish-nxënësin e shkollës “Ismail Qemali” dhe në të njëjtën kohë ish-nxënës i shkollës profesionale “Hamdi Bushati”, Risalt Ceka.

Në takimin me nxënësit ai u shpreh se rrugëtimi i tij nuk ka qenë aspak i lehtë, por ia ka dalë falë punës dhe mbështetjes së mësuesve, të cilët siç thotë ai e orientuan drejt prirjeve dhe aftësive të duhura.

Risalti tani punon si mësues në shkollën profesionale “Hamdi Bushati” dhe në të njëjtën kohë edhe mësimpldhënës në Qendrën e Formimit Profesional si mësues i moduleve të turizmit.





